



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.916/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e Shukrije Shala, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i e Shukrije Shala, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Klinë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Podujevë nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë në Qendrën e Votimit QV nr. 0801C-04R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutin e Qendrës së Votimit si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Shukrije Shala, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Klinë, me të cilën pretendon se në Qendrën e Votimit QV nr. 0801C-04R sipas Formularit për Rezultate të Kandidatëve në KKZ ka 6 vota, pra edhe sipas publikimit të rezultateve nga KQZ-ja i ka të njëjtat vota. Më tutje ka theksuar se në QNR, me rastin e publikimit të rezultateve aty nuk më figuron asnjë votë në këtë qendër votimi. Prandaj PZAP-it i ka kërkuar që të publikoj votat që më janë keqpërdorur.

Në cilësi të provave si dëshmi apelit i ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Fletlisten e kandidatëve nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për Asamble Komunale në Klinë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmerinë së pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka pa rregullsi me rastin e publikimit të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezultojnë edhe nga pretendimet ankimore në ankesë nga vetë pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i e aprovoj apelin e apeluesit si të bazuar dhe e urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidaten nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Qendrën e Votimit të cekur më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura PZAP-i vendosi si në pjesën II të dispozitivit të vendimit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha më lartë, në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.916/2017 me datë 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.